



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **26.06.2019 ( e Mërkure)**, në Zyrën e Drejtorit të Administratës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, Zyra për Barazi Gjinore dhe përfaqësuesi i KDI-së, OSBE-ja. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Ju njoftoj, që MAPL-ja naj ka konfirmu pjesën dërmuese të ligjshmërisë së akteve që janë miratuar nga seanca e fundit. Diçka të veçantë nuk kemi, tani kaloj në pyetje dhe përgjigje jashtë rendit të ditës.

**znj:Liridona Bislimi:** Ne edhe ma herët e kemi përmendur në kuvend, por unë tash desha ta bëjë propozim që të harmonizohet Ligji për Ndalimin e Hedhjes së Fletushkave që po bëhen njoftime të maketeve. Po besoj që është një propozim me vend, se ditë e ma shumë në Viti është duke u shtuar ky fenomen.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Si propozim shumë me vend, se edhe po ndotet ambienti vetëm se duhet ta shikojmë aspektin ligjor, besoj se na si kuvend kemi të drejtë.

**z.Bekim Azizi:** Kisha bërë një pyetje por nuk kisha ditë kujt me ju drejtuar këtë rrethin në Smirë që e keni bërë. A ka dikush ndonjë informatë, kush e ka lejuar me u bë pse mu ba drejtor i Inspeksionit. Ndoshta mundesh me ditë ma mirë, sepse vendi është shumë i ngushtë. Unë mendoj se dikush ka me u penduar ma vonë, sepse shpesh kanë ndodh edhe aksidente për shkak të shpejtësisë thjeshtë a ka ndonjë prej juve ndonjë informatë rrethe këtij rrethi që është bërë.

**z.Ibrahim Rama:** Operatori ekonomik që e ka kryer që është duke bërë atë rreth edhe ideja e projektuesit është menduar ashtu d.m.th. është projekte i skicuar qysh është duke u ekzekutuar në teren. Sa i përket anës profesionale nuk kam diçka me thanë saktë.

**z.Bekim Azizi:** Do me thanë barrën e keni ju komuna, e keni bërë një rreth pa mbajt dëgjim publik, pa u konsultuar me kanë pa e analizuar fazën e rrezikshmërisë që mund të jetë aty. Unë e ngrita një shqetësim të banorëve, që mendoj që është me vend.

**z.Jakup Demiri:** Kam një kërkesë prej lëvizjes vetëvendosje me sjell si formë informate raportin e auditorit të jashtëm

**Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu:** Çështja e marketingut që e ngriti këshilltari duhet me shikuar aspektin ligjor, nëse na i lejon aspekti ligjor jemi në rregull. Bekim, unë kam qenë në takim kur është ngritë si çështje dhe është konsultuar edhe inspektori i komunikacionit i cili është ma kompetent për këtë çështje dhe tash sa paraqet rrezikshmëri nuk mundem me thanë. Edhe çështjen e auditorit u informuat se do ta sjellim në seancën e ardhshme. Dje e kam pas një thirrje telefonike prej kohës ditore, unë isha me një takim në Gjilan, por edhe jo boll i përgatitur, a dinë prej kur mbahet mësimi jo formal në shkollën e mesme teknike, se unë nuk e kam këtë informacion.

**z.Bekim Azizi:** Nuk e di saktësisht, por përpara është quajtur mësim privat, por tana u organizua mësimi jo formal, nuk e di a është 2011/2012 se di sigurt.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi nuk kemi tjerë për të diskutuar, para anëtareve paraqes këtë:

**R e n d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e KPF-së**
2. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2020.**

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm:

**z.Bekim Azizi:** Duke parë pikat e rendit të ditës, për seancën tjetër kisha kërkuar një pikë apo informatë për ndërtimet pa leje, sa kanë shkuar ndërtimet pa leje.

**z.Skender Ahmeti:** Është mirë me precizuar kohën prej kur deri kur, se na nuk mund të flasim në hava.

**z.Jakup Demiri:** E kemi pas një kërkesë për një pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Unë kam bërë përpjekjeje, e kam dërguar zyrtarin tim edhe në Prishtinë. Me thanë një gjë mundemi me bërë tha me prur vend edhe me ja shfuqizua vendimin në aspektin ligjor si kuvend, tha nuk keni të drejtë me marrë asnjë vendim.

**Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu:** Fatlumi është marr shumë me këtë problem, pjesë e marrjes kam qenë edhe unë dhe me kanë thirrë nga Prishtina. Ka qenë me Kujtim Aliun. Edhe këtë çështje ai më ka thanë, ju mund ta sjellin, por kjo shpallet e pa ligjshme. Çështja të cilën ti po e shtron sot është diçka tjetër nëse ka iniciativë nga krejt Kosova e qojnë në parlament, i hynë ndryshimit të ligjit. Tani diskutojmë diçka tjetër, tash për momentin nuk mundemi me ba asgjë se na i kthejnë të pa ligjshëm.

**z.Bekim Azizi:** Unë kisha me plotësuar, na si kuvend me dal me një deklaratë këtë shumën shtesë që donë me shti për televizion.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Kush është që të miratohet ky rend dite? Konstatoj se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e KPF-së.**

A ka dikush rrethë kësaj pike të rendit të ditës ju lutem? Nëse nuk ka, po e qes në votim. Konstatoj se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

### **2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2020-2021**

Ja kish akaluar fjalën drejtorit që të na i paraqes në pika të shkurtra.

**z.Ibrahim Rama:** Po është dokumenti i përgatitur nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, që ka të bëjë me fillimin e procesit të përgatitjes së buxhetit për vitin 2020 dhe projeksionet për vitin 2021/2022, pra jemi në fillim të dinamikës së punëve deri në shtator kur edhe miratohet buxheti nga kuvendi Komunal. Deri në atë kohë janë disa hapa që duhet me i ndërmarë qeveria komunale të përgatitjes së këtij drafti dhe ky fillon me 15 maj kur na ka ardhur qarkorja e parë dhe na kemi filluar me përgatitjen e hapit të dytë e kështu me radhë deri sa të miratohet buxheti. Materialin e kemi marrë me kohë, për pyetje, përgjigje jam në dispozicion që të ju përgjigjem. Ju faleminderit.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush?

**z.Bekim Azizi:** Korniza afatmesme buxhetor 2020-2022, që parashihet, na ka ardh në parim, nuk ka ndonjë ndryshim të madh nga viti i kaluar që e kemi diskutuar dhe vërejtjet që i kemi dhanë tash 1 vit të lidh edhe pjesa e shkrimit thuajse nuk ndryshon shumë, vetëm e vetëm se janë ndryshuar vitet është problem sa garantojmë zhvillim me këtë buxhet të tillë. Një biznes mund të ketë të hyra sa ka komuna me 1200 punëtorë, nuk shihet në parim një ngritje e buxhetit që është interesi të gjithëve që me pas ngritje të buxhetit, edhe pse

ka hy tash, pjesa e tatimit në pronë, këtu i keni qit vetëm te të hyrat në planifikim 51 mijë euro këtë vit me duket ka qenë, subvencione 70 mijë euro. Subvencione nuk e di a kanë të ndara saktësisht nuk kemi një listë rapë të investimeve kapitale që mund të diskutojmë. Unë mendoj se kur vjen një kornizë buxhetore u kanë mirë me ardh edhe një listë që me pas mundësi me zberthi atë listë. Nëse ju kujtohet vitin e kaluar kur e kemi miratuar kornizën buxhetore, aty e kemi pas parapa 2019, 2020, 2021. Për vitin 2020 na e kemi pas edhe tabelën që e kemi parapa me një far forme, projektet që duhet të i implementojmë e tash sa do t'i orientojina në këtë që i kemi planifikuar, se parimisht ne e kemi miratuar një kornizë që është 3 vjeçare, a do të shqyrtohet ajo kornizë a është bazë e asaj që një mbështetje se edhe është e miratuar, tash nuk po di sa jemi duke ju përmbajtur atij miratimi. Tash dua të lidhem te të hyrat vetanake, duhet me ba një analizë, p.sh.: te të hyrat në qira ne e kemi pas kërkuar një raport dhe ti e ke sjell një raport qa ka qenë absurd. Unë për vete nuk po e shoh të plotë këtë raport, sidomos te pjesa e investimeve kapitale, se tash kur vjen buxheti përgjithshëm, na e kemi edhe kartelën analitike që e shohim mirë dhe të parapamë çdo kod buxhetor, mirëpo unë mendoj një orientim pak ma shumë te investimet kapitale duhet me qenë një orientim ma i mirë, ti i ke pas edhe debatet me qytetar vitin e kaluar me shiku qa u realizuar dhe çka jo the se na këshilltaret edhe nuk kemi qenë aktiv në debate, mirëpo nja e di se është buxheti i gjashtë që je merr ti si drejtor, hala nuk e di se këshilltaret kanë mund me propozuar një cent edhe ti me fut në buxhetin që e keni pru. Ma shumë se 60% e buxhetit te investimet kapitale nuk ka qenë e specifikuar, përpos projekteve të përgjithshme që ti e din si kanë shkuar.

**z.Ekrem Abazi.** Po mundohem mos me i përsërit çka tha parafolësi, por te vizioni i komunës për dy vitet e ardhshme, dy rreshtat e fundit thotë me shërbimet financiare të zhvilluara dhe krijim të kushteve ma të mira të jetës për qytetarët e saj, çka keni menduar me shërbime financiare të zhvilluara? Bankat që po na rrjepin me ba sa ma shumë në Viti apo çka, unë kështu e kam kuptuar dhe kushte ma te mira për qytetar, çfarë kushte qytetarët me asfalt janë ngirë, ma qytetari donë punësim, se me asfalt e me drita. Tash po e she sa po na kushton buxheti, se keni qu ndriçim publik edhe aty ku nuk ka pasur nevojë hiq, se me ba është letë a me mbajt është shumë vështirë, çka keni menduar te burimet e të ardhurave, p.sh.: shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit në vitin 2019 i keni paraparë 62400 euro, as 10% s'keni mund me i bë këto, vjeljen e këtyre tatimeve në vitin e ardhshëm i kishit paraparë 97000 euro. Nëse filloni lejet për ndërtim me ba pagesën qytetarët këtu kanë me u mbledh 500 mijë euro, se këtë vit s'keni mund me mbledh asnjë, ndërsa vitin e ardhshëm keni me mbërri pa problem këtë shumë, se mund me u mbledh edhe 200 mijë euro. Taksat e pronës, 400 mijë euro sivjet, 430 mijë euro vitin e ardhshëm, pse janë zvogëluar taksat, p.sh.: unë gjatë vitit 2018, faktura ime ka qenë 51 euro tash është 66 euro vetem te un e pash se është rrit për 15 euro por nuk e di edhe pse po bahet tatimi në tokë vetëm 30 mijë euro po shtohet, nuk e di cila është arsyeja, të ardhat të tjera 31, i pasni paraparë 35 mijë. Nuk e di qa janë të tjera. Te mësimi jo formal, mirë, te subvencionet nga 277 mijë euro që janë paraparë, 140 mijë euro mi pas kryetari, 32 mijë euro mi pas subvencione Bujqësia, nuk e di a keni menduar fare ose te kryetari mi pas 150 mijë euro mallra dhe shërbime, nuk e di qa keni menduar me ta.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, te ky dokument që e kemi nga viti i kaluar, nuk do të thotë se ndryshon shumë. Te partneriteti publiko privat çka keni paraparë, a ka ndonjë iniciativë të re apo qysh ka qenë grande dhe subvencione. Te kategoritë ekonomike buxheti i ndarë sipas kategorive ekonomike, paga dhe shtesa, nuk është me rendësi. Te shpenzimet kapitale, e keni cek atje, KAB-i përcakton mekanizmat e nevojshme për mes të cilave objektivat prioritare, këtu nuk pash që ka objektiva të qarta prioritare dhe objektivat dihet se 90% e kuptimit të objektivit përcakton kohën apo afatin e fillimit dhe të mbarimit të diçkaje të jetë si matës statistikor për arritjen e një diçkaje në këtë rast të investimeve, kanalizim edhe ujësjellës në Komunën e Vitisë brenda tri viteve, mbas një viti ku kemi me mbërri na, çfarë objektiva i kemi vendos vetes. Te shpenzimet kapitale këtu është vetëm shuma 251225 euro 18.29% unë i shikova disa prej komunave që i kanë bërë KAB-in, më pëlqej një e Klinës po e marr një shembull si duhet të jetë orientimi i projektit asfaltimi i një rruge financimi Ministria e Integritetit, përshkrimi nga komuna, komentet e banoreve të asamblesë mbahen diskutimet këtu ishte edhe sasia koha e fillimit dhe e mbarimit të gjitha të përcaktuara e që këtu një pash që ka diçka të tillë. Kjo te investimet kapitale përveç shumë që paraqet programet te shëndetësia dhe mirëqenia sociale, po mendoj ajo lista që ish me mërimë këtu, a garantoni se ajo do të funksionalizimet se e dimë edhe prej dokumenteve të mëhershme, si disa prej sektorëve nuk kanë funksionuar dhe krejt në fund që i kam nxjerr, rregullimet në investimet kapitale do të jenë të orientuara më shumë në asfalt a në kanalizim apo ujësjellës, këto nuk i keni të specifikuar ky dokument nuk paraqet dokumentin që unë e kërkoj vazhdimisht këtij dokumenti apo ky dokument nuk pasqyron politika të reja teknike është shumë i dobët nuk kam pa ndonjë sqarim që edhe se ndoshta kemi kohë hala kemi mbledhje të tjera, kjo është shumë e përgjysmë nuk ka perspektive gjinore kur dihet se shumë dokumente duhet. Nuk ka listë të prioriteteve në investimet, nuk ka numër të përcaktuar të

punëtoreve të arsimit në Komunën e Vitisë. E dimë moti edhe problemin e ujit. Ne si Lëvizje Vetëvendosje i kemi bërë disa prioritete që duhet të futen, të rritet kapaciteti i ujit, kyqja e Skifterajt, Budrikës dhe Remnikut në Ujësjellës, dezinfektimi dhe dezinfektimi i objekteve shkollore që unë kurrë nuk po e ni këtu në Viti. Vaksinimi i qeneve shtëpiak, ndërtimi i aneksit të shkollës “Kuvendi i Lezhes”, se dihet se nxënëset nuk kanë ku të zhvillojnë aktivitetet, ndërtimi i gypit të asbesit në tërë territorin e Komunës së Vitisë, trajtimi i ujërave të zeza në Smirë dhe Sllatinë. Në Smirë po derdhet kanalizimi në livadhe, kontrollet mjekësore sistematike të fëmijëve për shkollën nga klasa e parë deri në të pestën, ka edhe shumë pika të tjera, por këto janë që i kemi ngritë ne. Edhe diçka kam të tubimet me qytetar, aty nuk ka pasur diskutim me qytetar, se aty kemi qenë unë dhe Liridona prej asamblesë dhe njerëzit prej komune, vetëm po ju them, se prioritete prej fshatrave nuk janë marr nga dëgjimet publike që janë mbajtur. Edhe diçka, një viq i ngordhur është në rrugën Smirë – Viti edhe një lopë e ngordhur në Lubishtë .

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush me shtua rrethe kësaj pike, nëse jo, drejtor ishte një numër i pyetje ta kisha kaluar fjalën

**z.Ibrahim Rama:** Po e filloj prej buxheti. Buxhetin ma shumë kryetari edhe ai që ka me ardhë ka me pas ashtu, se ata marrin nota pozitive për me pas buxhetin ma shumë, se punojnë ma shumë. Si shumë e buxhetit, krejt kemi qef me qenë shuma ma e madhe, por mundësitë janë të tjera. Neve na është caktuar buxheti 12 milion e diçka, tash këtë buxhet, Unë pajtohem se duhet me gjetur zgjidhje na me adresuar sa ma mirë sipas kërkesave të qytetareve aty vlerësohet qeveria komunale me kryetarin a është duke punuar mirë a jo. Tash ka shumë problematika që komuna nuk ka sovranitet të plotë, mbasi ti se përcakton buxhetin. Po lidhem me pyetjet, p.sh. subvencionet. Unë 100 herë kam bërë problem në Ministri të Financave edhe Ministri të Bujqësisë, decentralizoni buxhetin e subvencioneve në bujqësi, se komunat dinë ma së miri ku mi dhanë parat për bujqësi. Na i kemi 46 mijë euro për bujqësi dhe vitin e kaluar i kemi rrit me propozimin e Ekremit me më vet mua ish nda pak ma ndryshe, por aty implementohet ideja e kryetarit të komunës, kur i ka fituar zgjedhjet e ka pasur një program një premtim elektorale për me ardhur kryetar komune. E dyta, janë projektet imediate ku qytetari e ndien ma shumë problemin të ujit të kanalizimi etj. E tash apo e ndajmë mirë brenda një viti, le të jetë që me shpresuar që mirë po mendojmë me nda. Unë e di se shumë kërkesa të këshilltareve komunal janë implementuar, na jemi në fillim të përgatitjes së buxhetit, d.m.th. krejt në fillim është e ndryshuar, asgjë kjo nuk vendos me kabin, kjo është vetëm një ide që ja kemi propozuar Ministrisë së Financave qysh me i nda, sa në paga sa në mallra etj. Tash ata me qarkoren e dytë na i sjellin qeta kufi. Kisha qenë falënderues me na ndihmuar, se unë e përmendi hala vërejtjen e Ekremit, tha unë kërkoj me i heqë 40 mijë euro qetu, mi qit këtu, kërkoj se është ma mirë unë po them na i analizojmë të gjitha kërkesat e dalura aty shkon shuma 7/8 milion euro gjë që na nuk mundemi ashtu, shkojmë duke i reduktuar dhe shikojmë cilat janë ma primare. Unë prapë po ju them juve, mundeni me propozuar konkretisht ku këtu me bë ndërrime. Të hyrat vetanake, vetëm në këtë pjesë të buxhetit vetëm 7,6% janë të hyra vetanake që komuna ka sovranitet të plotë, pjesa tjetër 92% është e përcaktuar nga niveli qendror. Debatet, Jakupi tha nuk kanë qenë të suksesshme, na e bëjmë në bazë të ligjit dy javë përpara paralajmërojmë gjithë qytetarët, me zor na s’mund e qesim askund, na e kemi me ligj me i mbajte ajo atë ditë u kanë e organizuar e komitetit. Edhe njëherë po them, na i kemi vetëm këto të hyrat 940 mijë euro qeto me i mbledhë. Ne kemi mbledhë bordin e drejtorëve dhe ju kemi thanë, të hyrat janë këto dhe sipas drejtorive qysh me paraparë, për ata se tha ma herët Ekremi keni me mbledh ma shumë se keni lejua me ndërtua pa leje, na nuk e kemi të kufizuar sa kemi me mbledh.

**z.Ekrem Abazi.** The me mbajtë debat me qytetarë. vjet keni mbajtë debate me qytetarë që ato janë vetem fontanë dëshirash, se ju apsolut nuk i shikoni ato se në shumë vende është individi ma shumë se krejtë qytetarët që janë të një fshati, se ndikimi i një individi është shumë i madh, sidomos në komunën tonë çka ke nevojë me mbajtur debate këtë vit. P.sh.: ta marrim Smirën, kjo ka pas prioritet asfaltimin e kësaj rruge, prioritet numer dy ka qenë kanalizimi, ti tash nuk ke nevoj me i thirr hiq, por ti 60% të buxhetit nuk e ke përcaktuar fare, nuk e ke dit ku punohet, çka u bë përshembull me rrugën tonë, ka qenë rruga Skifterajt të vorret e luftës janë ndarë edhe parat, se dini qa u ba se janë vjedhë ato parat, keshtu që nuk ke nevoj me mbajtur debate me qytetarë fare, se janë mbajtur vitin e kaluar edhe i keni shenimet. Po e marr një shembull, Debolldhehi edhe Goshica janë fshatrat që kanë përfituar ma së shumti, se e permendet për kokë banori, ajo është veq fjalë edhe një her kisha propozuar që mos me pas debate hiq me i mundu qytetarët palidhje.

**Znj.Liridona Bislimi:** Unë e kam gjetur te web faqja e Gjilanit që janë mbajtur diskutime në fashatin Drobesh edhe Lubishtë u kanë në vitin 2014/2015, nëse nuk gaboju trotuarin, ndriçimin, rrugën kryesore, ndërtimi i shkollës së re dhe nënkalmi ose mbi kalimi tash jemi në vitin 2019, ju keni bërë disa investime në Drobesh, por ju s’keni ma nevojë me ardh se i dini kërkesat e banoreve.

**z.Jakup Demiri:** drejtor kjo është ma shumë strategji te puna e prioriteteve. Na prioritet na mundemi me u përcaktua për fshatin tonë, por cila është prioritet, se vitin e kaluar ka qenë asfalti këtë viti a është ujësjellësi edhe kanalizimi se e dimë, se kanë kosto ma të madhe, a i keni paraparë për këtë vit këto? Bile kryetari ka pas thanë se do ta rrit buxhetin deri në 20 milion, por ne dimë që nuk bëhet kjo. Ka premtuar edhe çerdhe nja 4 sish.

**Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu:** Vetëm desha me të përmirësuar, se jo 20, por 25 milion, po jo buxhetin, por investimet brenda territorit të komunës brenda katër viteve.

**znj.Gjylsime Qamili:** Desha një shpjegim sa i përket kontrollës së nxënësve. Ne kemi bërë vizita tash e kemi pas një projekt të gjitha klasat e gjata, kemi bërë kontrollon e nxënësve për një muaj rresht.

**Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu:** Këtu u debatua shumë për çështjen e debatit, por megjithatë na nuk e kemi qare se po të obligojnë me i mbajte. Desha me u lidh edhe te çështja e subvencioneve jo me u arsyetuar, por me treguar, ky 140 mijë euro te Zyra e Kryetarit, kjo është shifër, këtu 40 mijë euro shkojnë për të vdekur 40 mijë shkojnë për bursa të studenteve, del edhe ndonjë marrëveshje tjetër edhe kryetarit nuk i mbesin ma shumë se 20 mijë euro.

**z.Bekim Azizi:** Unë nuk besoj se sa herë keni diskutuar prioritet rrethin në Smirë, kujt bile ni pat shkuar mendja se ai rreth duhet me u ngritë në dy kate, kujt nuk ju ka dashtë. Te Drejtorja e Arsimit ku ka qenë trotuari ka qenë aty, tash ju ka shtua edhe një aty, a ka mund me krejt këto me u bërë një projekt përnjëmend që është i nevojshëm, shembull asfalti që ka ardh deri te xhamia, deri te dera ime, as aty nuk ka qenë prioritet i askujt kjo është se nuk janë të definuar projektet edhe për me të ardh në fund mirë buxheti. Prioritet është uji drejtor, ku ka ujë me pi ku shumica e qytetareve shkojnë mbushin ujë hala që gjashtë vite buxhet kemi ndarë asnjëherë s'kemi paraparë për ujë është urgjente. Kanalizimet që i keni bërë pa gropa septike, që është e ndaluar me ligj me derdh kanalizimin nëpër lumenj. Unë mendoj se është ma mirë me u orientuar në projekte qa janë ma urgjente që i ceka.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Pasi nuk ka tjerë për diskutim, unë e kisha qitë në votim që të shkoj për miratim. Kush është që të shkoj në kuvend kjo pikë. Me tri vota pro dhe katër kundër nuk shkon në kuvend.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi :

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren mbi themelimin dhe strukturimi e asamblesë komunale të fëmijëve**

Janë dy rregullore që kanë qenë edhe në debat publik i kena përmbush kriteret ligjore dhe na u janë kthyer në kuvend.

**z.Flamur Zeqiri:** Ne i kemi ndjekur të gjitha procedurat sa i përket kësaj rregullore, këto kanë kaluar përmes dëgjimit publik, në dëgjim kanë marr pjesë mësues, qytetar dhe nxënës. Pasi e keni para vete rregulloren, nuk dua të ju marr kohë ma shumë.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës, a donë ta merr fjalën dikush?

**z.Jakup Demiri:** Si dokument ka sqarime të mira. Te financimi p.sh.: mjetet e nevojshme për funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të realizohen përmes planifikimit 1 vjetor komunal dhe qeveritar etj. Ky paragraf që është i shkruar, mua nuk po më pëlqen për formën, se nuk e ka të sanksionume mirë formën e te kontributet vullnetare të nxënësve, shqetësimi im është te prindërit, mësuesit dhe nxënësit, për arsye se në të kaluarën e afërt pa dashtë me keqpërdor emrin si mësimdhënës, por personat e caktuar kanë bërë lloj lloj loje edhe kjo mund me vazhduar edhe më shumë se bëjnë organizime të ndryshme.

**z.Flamur Zeqiri:** Ku jemi te buxheti, aty jemi te gjykimet dhe paragjykimet kur kemi të bëjmë me një asamble komunale për fëmijë, të cilat janë të strukturuar me të gjitha organet e veta. Unë ju siguroj në bazë të asaj që është e shkruar, se gjithçka edhe fondet të cilat shtesë janë të specifikuar do të menaxhohen nga vet nxënësit.

**z.Bekim Azizi:** A keni paraparë kosto buxhetore dhe sa do të jetë ajo nuk besoj, se kanë drejtë me pas llogari të fëmijëve, sepse banka nuk i lejon fëmijët me pas llogari në vete pa mbikëqyrjen e prindërve. Nuk munda me gjete formën qysh zgjidhet një anëtar i këtij këshilli prej 27 anëtar nuk është e parapamë se si kanë me u zgjedh.

**z.Flamur Zeqiri:** Çështja e buxhetit, e dimë se për shkak të moshës zhvillimit fizik edhe shumë parametra të tjerë realizimi i të drejtave të fëmijëve duhet me qenë në mbikëqyrje të prindërve, pastaj vjen kujdestari pastaj vinë institucionet e kështu me radhë. Sa i përket buxhetit, ai do të grumbullohet dhe do të specifikohet varësisht prej aktivitetit, aktivitetet duhet të jenë të bazuara me një plan të cilin kanë me hartuar kjo asamble.

**Kryesuesi z.Naim Pira:** A ka dikush tjetër rrethë kësaj pike? Atëherë e hedhim në votim. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë.

Si pikë tjetër kemi

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunale Miqësorë për fëmijë**

Edhe kjo rregullore e ngjajshme është, po e hedhim në votim. Kush është që të shkoj për miratim? Konstatohet se me vota unanime shkon për miratim.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik propozim rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së subjekteve të biznesit në Komunën e Vitisë**

A ka dikush rrethë kësaj pike, nëse nuk ka e hedhim në votim edhe këtë pikë. Konstatohet se me vota të gjithëve shkon në kuvend.

Edhe si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2020**

Këtë propozim vendim e kemi që ta formojmë një komision nga të gjitha grupet parlamentare, një nga sekretaria e kuvendit dhe një nga shoqëria civile për hartimin e planit vjetor të Komunës së Vitisë për vitin 2020. A ka dikush rreth kësaj pike? Nëse nuk ka e hedhi në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se me vota unanime shkon në kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje, mirë u pafshim në takimet e radhës.

Mbledhja përfundon në ora: 11:50

**Procesmbajtësi:**  
**Ilir Zuka**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**  
**z.Naim Pira**

---